



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

Data: 12.5.2023

Nr: 506

Ora: 17:00

**VENDIM**

**PËR**

**LIRIM DHE EMËRIM TË ANËTARIT TË KZAZ-SË NR. 48, BASHKIA ELBASAN DHE ANËTARIT TË  
KZAZ-SË NR. 73, BASHKIA KORÇË**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “ç”, dhe 2, nenit 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**V Ë R E N:**

Referuar nenit 32, pika 2, shkronja “d”, të Kodit Zgjedhor, janë kërkuar zëvendësime të anëtarëve në KZAZ-të si më poshtë:

Partia Demokratike e Shqipërisë, me kërkesat nr. 5062 prot., dhe nr. 5064 prot., datë 12.05.2023, ka kërkuar zëvendësimin e anëtarit të KZAZ-së nr. 48, Bashkia Elbasan dhe KZAZ-së nr. 73, Bashkia Korçë.

Propozimet dhe kandidaturat e paraqitura, plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenet 30, 31 dhe 32, pika 2, shkronja “d”, të Kodit Zgjedhor.

**PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “ç”, dhe 2, nenet 30, 31 dhe 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

## V E N D O S:

1. Lirimin nga detyra të anëtarit të KZAZ-së nr. 48, zj. Anila Ismail Qoqi, Bashkia Elbasan dhe anëtarit të KZAZ-së nr. 73 z. Mariglen Bujar Gjolla, Bashkia Korçë.
2. Emërimin e anëtarit të KZAZ-së nr. 48, z. Flori Haki Biçaku, Bashkia Elbasan dhe anëtarit të KZAZ-së nr. 73, zj. Monika Pellump Beqiri, Bashkia Korçë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe i njoftohet KZAZ-së përkatëse.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**